



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 07

Prishtinë, më 23.1.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe
Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Armend Zemaj, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Agim Ademaj, Melihate Termkolli, Doruntinë Maloku dhe Milena Miliqeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Enver Peci- KGJK, Margarita Kadriu-deputete, Etleva...- Kosova Sot, Yllka Buzhala – CRDP, Mark Housl dhe Edita Kusari – EROL/USAID, Yordan Sirakov dhe Alexandra Pepoff – EULEX, Arton Demhasaj – Çohu, Liridon Sadiku – IKPZH, Ardian Bajraktari – MD dhe Armend Shkoza – LVV.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Diskutim lidhur me propozimet për emërimin e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës

Melihate Termkolli, paraqiti vërejtje në lidhje me thirrjen e mbledhjes së Komisionit në të njëjtën kohë kur edhe po zhvillohen punimet e mbledhjes plenare. Ajo tha se kjo nguti është e panevojshme, kështu nuk punohet sepse ne kemi edhe obligime në seancë dhe kemi mundur që ta shtymë mbledhjen e Komisionit. Propozoj që mbledhja e Komisionit të shtyhet.

Kryetarja sqaroi se arsyeja pse kjo mbledhje nuk është shty, është se mbledhja është caktuar para mbledhjes plenare.

Kryetarja, hodhi në votim propozimin për rendin e ditës dhe me shumicë votash komisioni vendosi që mbledhja të mbahet sipas rendit të ditës.

1. Diskutim lidhur me propozimet për emërimin e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Kryetarja përshëndeti të pranishmit, njëherësh përshëndeti kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe e falënderoi për gatishmërinë që ka treguar për ta njoftuar Komisionin, në lidhje me gjendjen aktuale të Këshillit, gjegjësisht për mandatin e disa anëtarëve të Këshillit. Ajo sqaroi se tashmë si Komision kemi mbajtur disa takime por e kemi parë të nevojshme që ta ftojmë kryesuesin për të na dhënë edhe disa sqarime shtesë. Në vazhdim, ajo bëri në përshkrim të shkurtër rreth gjendjes në Këshill. Siç e dini, tha ajo, tashmë Këshilli nga 31 gushti është jofunksional, pasi disa anëtarëve ju ka skaduar mandati. Këshilli ka 13 anëtarë, ku prej tyre me mandat janë 5 prej gjyqësorit dhe 3 nga Kuvendi. Kuvendi duhet të emëroj 5 anëtarë dhe atë: 3 shqiptarë, siç përcaktohet në nenin 108, paragrafi. 6, pika 2 e Kushtetutës, 1 serb sipas nenit 108, paragrafi 6, pika 3 dhe një anëtar nga komuniteti tjetër, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, pika 4. Këshilli i ka propozuar Kuvendit diku rreth 114 emra, siç thuhet në letrën përcjellëse për t'ia lehtësuar punën Komisionit. Ajo adresoi pyetje për z. Peci se përse janë përfshi në listë si propozime emra të cilët janë nën hetime dhe disa nuk kanë përvojë të gjatë si gjyqtarë ? Po ashtu vërejtje paraqiti edhe rreth propozimit të Odës së Avokatëve, e cila ka propozuar vetëm një emër. Tani ju e dini që ne nuk jemi të obliguar të vendosim sipas këtyre propozimeve dhe për të sqaruar si janë bërë këto përzgjedhje, kemi ftuar edhe kryesuesin e Këshillit, të cilin e ftoj që të marrë fjalën, tha kryetarja Albulena Haxhiu.

Enver Peci tha se lidhur me atë se si është gjendja në KGJK, kryetarja i përmendi disa prej tyre. Fillimisht dua të sqaroj se është përgjegjësi absolute e Kuvendit se kënd do ta zgjedh për anëtarët që janë kompetencë e Kuvendit sipas Kushtetutës dhe ligjit. Mirëpo, në vazhdimësi Këshilli është konsultuar në kuptimin e emërimit nëse emërohen gjyqtarë, pra kjo ka qenë arsye pse në atë kohë Këshilli Gjyqësor ka mbajtur takime dhe ka shkruar sugjerime për Kuvendin, nëse nga radha e pesë anëtarëve dikush emërohet nga gjyqësori, kemi dhënë CV-të e tyre. Ju e dini që bashkërendimi i organeve në mes të pushtetit legjislativ dhe gjyqësor është i domosdoshëm, faktikisht nuk mundet njëri pa tjetrin, dhe pikërisht kjo ka qenë ideja që si këshill t'ua lehtësojmë punën, duke propozuar emra, mirëpo këtë mos ta kuptoj askush, që ka qenë qëllim i këshillit që duhet të emërohen këta gjyqtarë siç janë propozuar.

Edhe në shkresën sqaruese të këshillit ju kemi thënë se nuk ju kemi propozuar emra, të cilët kanë dosje disiplinore. Po ashtu kemi propozuar kandidatë nga regjionet që nuk janë të përfaqësuar si Peja, Gjakova, Gjiçani dhe Mitrovica, me sugjerimin që të kihet parasysh përfaqësimi nga

regionet që aktualisht nuk përfaqësohen në Këshill. Ashtu siç e tha edhe kryetarja, nga 5 anëtarët që i zgjedh Kuvendi, 3 shqiptar dhe 2 nga komunitetet tjera, vetëm një duhet të jetë gjyqtar. Por do të ishte mirë që në Këshill të jenë edhe të tjerët nga gjyqësori sepse kanë një përvojë dhe mund ta begatojnë punën e këshillit. Kurse sa i përket të kaluarës, sidomos dy vitet e fundit, Këshilli asnjëherë nuk është plotësuar me 13 anëtarë, kurse me përfundimin e mandatit të dy anëtarëve ndërkombëtarë dhe një anëtari nga nacionaliteti serb, këshilli është pa kuorum. Dëshiroj t'ju them se asnjëherë nuk guxon Këshilli që me ndonjë anëtar të ndikoj tek komisioni apo tek deputetët. Pikërisht për këtë kam qenë shumë i kujdesshëm, dhe për këtë a ka ndonjë deputet që mund të thotë që e kamë favorizuar ndonjë emër, he nëse ka lirisht le ta thotë këtë publikisht. Prandaj unë jam shumë i interesuar, që në Këshill të kemi profesionistë dhe që punojnë në interes të Këshillit edhe pse kjo është punë e vështirë edhe për ju, pasi që nuk ka procedura të specifikuar.

Meqë Këshilli është pa kuorum, neve na duhet edhe një anëtar, që të mund të mbahen takimet e Këshillit, prandaj ju, jo domosdoshëmërisht duhet t'i zgjidhni të pesë anëtarët tani. Funksionaliteti i Këshillit është i nevojshëm sepse pritet emërimi i 50 gjyqtarëve vendorë dhe i disa gjyqtarëve të EULEX-it, që kalojnë përmes Këshillit si dhe shumë vendime tjera, në lidhje me lëndët e caktuara. Kurse lidhur me atë, pse Oda e Avokatëve ka propozuar vetëm një kandidat, ju njoftoj se nga Këshilli kërkesa ka qenë të propozohen së paku tre emra. Në fund ju falënderoj për mundësinë që m'a dhatë për të ofruar sqarimet e duhura për këtë çështje, theksoi Enver Peci.

Margarita Kadriu në fjalën e saj tha se nëse për diçka njihet Republika e Kosovës, ajo është për dështimin në sundimin e ligjit. Ju jeni kryesues që sot administroni me organin më të lartë që administron me sistemin gjyqësor dhe skandalet i keni të njëpasnjëshme.

Në fjalën e deputetes Margarita Kadriu ndërhyri kryesuesi i Këshillit, i cili tha se nuk përgjigjet në këto pyetje sepse nuk janë në rendin e ditës dhe janë çështje politike, për të cilat nuk dua të diskutoj sepse nuk kam ardhur të debatojmë për sistemin gjyqësor.

Margarita Kadriu më tej tha se emrat të cilët kanë ardhur nga ju janë kundërkushtetues sepse keni propozuar emra, e që kjo nuk është e drejt e Këshillit.

Ajo pyeti se si është e mundur që gjykatat t'ju propozojnë emra të cilët janë nën hetime, pra që hetohen nga Agjencia kundër korrupsionit, nga prokuroria për lëndët e humbura ? Unë e di që ata kanë të drejtë të bëjnë këso propozime, por pse ju ua sollët Kuvendit këta emra, kur keni qenë të vetëdijshëm se janë emra të implikuar, në një mënyrë ose tjetrën në shkelje të ligjit. Kurse për gjëra tjera shihemi në mbledhjen e Kuvendit dhe keni durimin dhe më dëgjoni pak më shumë, tha Kadriu.

Armend Zemaj theksoi se qëllimi i Komisioni, që e ka ftuar kryesuesin, është për shkak të rëndësisë që ka ky institucion, veçanërisht në zgjedhjen e anëtarëve të tij, me qëllim të

funksionalizimit sa më të shpejt. Zëmaj tha se bashkëpunimi ndërinstytucional edhe në të kaluarën ka qenë i tillë, që të ruhet autonomia, por duke gjetur mundësitë më të mira për të avancuar atë që është më e mirë dhe të ndalojmë atë që e degradon sistemin e drejtësisë në vend. Andaj një ndër shtyllat e gjyqësorit është Këshilli Gjyqësor dhe deshëm apo jo, prej aty burojnë të gjitha këto elemente. Ideja që ju kemi ftuar, ka qenë që të na ndihmoni më shumë sesa ne që mund të kem informata rreth personave dhe CV-ve të tyre, për të bërë një përzgjedhje sa më të mirë. Në këtë komision ekziston vullneti që politika t'i ketë duart larg nga drejtësia, duke bërë një përzgjedhje adekuate. Pra, është më rëndësi që në këtë fazë të jemi bashkëpunues për aq sa na lejon kushtetuta dhe ligji, duke i zgjedhur të 5 anëtarët sepse nuk kemi nevojë që ta shtyjmë procesin, tha Zëmaj.

Selviqe Halimi tha se u përmend disa herë se kjo mbledhje ka për qëllim që të diskutojmë për të hequr dilemat që i kemi për çështje të caktuara dhe jo të marrim vendim sot. Kurse sa i përket asaj që ka informata se në listën e Këshillit ka emra që janë duke u hetuar, është mirë të na thuhet se kush janë ata emra, në mënyrë që ne të marrim masa t'i heqim nga lista apo të kërkojmë informata shtesë.

Milena Miliçević, tha se pasi që materialin e kam marrë dje në mëngjes, lidhur me biografitë për kandidatët potencial, nuk kam pasur kohe ti shikoj dhe nuk kam njohuri se a janë nën hetime. Po ashtu sa kamë arritur të kuptoj, lista nuk është përfundimtare dhe desha të dijë se a munden grupet parlamentare të propozojnë kandidatë apo do të jetë vetëm nga kjo listë ?

Enver Peci tha se në listat për minoritetet janë vetëm emrat e gjyqtarëve dhe nuk është e domosdoshme që të gjithë anëtarët nga këto komunitete, të jenë gjyqtarë sepse janë me mandat dy gjyqtar, pra dy të tjerët, mund edhe të mos jenë gjyqtarë, sepse kushtetuta thotë të paktën njëri duhet të jetë gjyqtar.

Melihate Tërmkolli tha se fillimisht dua të sqaroj se ne patëm kërkuar një raport nga Këshilli dhe vetëm nga USAID-i kemi marr një material, që as vet s'e di se çka është, kurse nga Këshilli nuk e kemi. Ne nuk kemi kërkuar raport vjetor, por kemi kërkuar raport për këtë çështje, për të cilën po diskutojmë. Kryesuesi sqaroi disa çështje, por për mua nuk janë shumë të qarta ose unë nuk jam e informuar sa duhet. Ajo çfarë bëtë me Margaritën, nuk është mirë, sepse nuk është jashtë rendit të ditës ngase e kemi thënë edhe në mbledhjen e kaluar, problemi më i madh është sistemi i drejtësisë. Kjo është direkt e lidhur me gjyqtarë dhe prokurorë dhe nëse është kështu për ne është shumë e rëndësishme të dimë se çfarë gjyqtarë dhe prokurorë po zgjedhim. Problemi qëndron se a është i obliguar Këshilli të na i sjell këta emra apo jo. Nëse jo, atëherë pse po na servohet diçka që nuk është e obligueshme. Ne si komision do t'i caktojmë kriteret për gjyqtarë dhe prokurorë që miratohen në Kuvend kurse modalitetin se si do ta bëjmë prapë do ta bëjmë ne deputetët. Andaj, mund të quhet edhe politike, por në Këshillin Gjyqësor ka grupe që punojnë për ta bllokuar punën e Këshillit Gjyqësor dhe jo vetëm të Këshillit por të të gjithë drejtësisë.

Këto grupe shtoi Tërmkolli, lidhen edhe me kryesuesin dhe nuk e kam të qartë këtë flirtim, e në njërin anë po themi që gjyqësori duhet të jetë i pavarur. Prandaj, Këshilli nuk mundet të imponoj diçka që nuk është e paraparë në ligj dhe Kushtetutë, pra të gjitha këto bien në ujë dhe ne si komision duhet të mbledhemi edhe njëherë dhe t'i përcaktojmë kriteret dhe të merremi vesh edhe për propozimet si do t'i bëjmë. Pra këto grupe, kryesues, i keni katastrofale dhe jeni duke punuar në mënyrë katastrofale dhe krejt ajo që thatë se duhet të propozohen nga regjionet e caktuara janë për ti forcuar edhe më tej këto grupacione në Këshillin Gjyqësor. Edhe propozimi se a duhet të zgjedhim një kandidat apo pesë edhe kjo është çështje e Komisionit, pse ne duhet të merremi disa herë më të njëjtën çështje, apo pse po ju duhet edhe një votë në Këshill.

Kurse lidhur me atë që thatë ndikimi në vendimmarrje është pak herët të flitet sepse ne s'kemi propozuar emra ende, kur të propozojmë emra, mund ta shihni a do të ketë ndikim apo jo, tha Melihate Tërmkolli.

Kryetarja duke u ndërlidhur me parafolësen, sqaroi se në shkresën e Komisionit dërguar Këshillit, është kërkuar më së largu deri me datën 22.1.2015, ta kemi një raport nga Këshilli lidhur me procedurat e ndjekura për të propozuar anëtarët për emërim nga Kuvendi. Prandaj do të ishte mirë, tha ajo, që këtë raport ta sillni sepse komisioni do të diskutoj për këtë çështje edhe në takimet e radhës. Kurse sa i përket propozimeve që ka sjell, ne e dimë që kjo nuk është përgjegjësi e Këshillit por e Kuvendit. Po ashtu ajo ishte e mendimit se edhe ata 5 anëtarë që vinë nga gjyqësori, duhet së paku formalisht të kalojnë përmes Kuvendit sepse tha ajo, e keni në Kushtetutë tek kompetencat e Kuvendit, neni 65 pika 10, kurse ligji pastaj sqaron se si bëhet përzgjedhja sipas nenit 108. Andaj, arsyeja pse pata kërkuar që të shkohet me konkurs publik është pikërisht që të mos të shkohet përmes grupeve parlamentare, siç ka ndodhur në të kaluarën, për anëtarët që zgjidhen nga Kuvendi, theksoi Albulena Haxhiu, kryetare.

Margarita Kadriu sërish tha se ne si deputet dhe si zëra të popullit nuk duhet të lejojmë që në këtë institucion të ketë ndikime politike, gjegjësisht njerëz kukulla dhe papërvojë në sistemin e drejtësisë.

Enver Peci sqaroi se sa i përket kriterëve ato janë të qarta, pra duhet 10 vjet përvojë pune, kurse lidhur me atë se edhe 5 anëtarët që vinë nga gjyqësori, nuk u pajtua me kryetaren sepse siç tha ky, neni 65, pika 10 thotë: “zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe prokurorial në pajtim me këtë kushtetutë”, e neni 108 e specifikon pastaj se si zgjidhen 5 anëtarët nga gjyqësori dhe të tjerët nga Kuvendi. Pra, theksoi Peci, ne bëjmë shkelje kushtetuese nëse prekim anëtarët nga gjyqësori sepse edhe ashtu po kritikohemi nga Raporti Progresit dhe është thënë se shumica e anëtarëve duhet të zgjidhen nga gjyqësori.

Kryetarja në fund adresoi edhe një pyetje për mandatin e kryesuesit të KGJK-së, ku sipas informacioneve që kamë tha ajo, mandati juaj përfundon në mars të vitit 2015, kurse në disa raporte thuhet në vitin 2016, si qëndron puna ?

Enver Peci tha se në kushtetutë kur kanë qenë në fuqi dispozitat kalimtare, ishte paraparë që 5 anëtarët që janë emëruar në Komisionin e Pavarur Gjyqësor, treve prej tyre mund t'u vazhdohet mandati njëvjeçar. Ne patëm vendosur në vitin 2011, që të respektohet ajo dispozitë kushtetuese sa ishte në fuqi. Mirëpo, unë jam i gatshëm sido që të interpretohet ta respektoj sepse nuk më bënë përshtypje nëse e përfundoj në mars të vitit 2015 apo 2016.

Kryetarja tha se kjo do të jetë edhe njëra nga çështjet që do të diskutohet në mbledhjet e radhës. Në fund falënderoj kryesuesin e KGJK-së për praninë e tij dhe e shpalli mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
